

EC
MA NDORYSHE

rtv
BESA

EUROPA

NBN
BOUTIQUE

1979 GRILL HOUSE
HYSKA
QEBAPTORE

dily/in

Souvenir SHOP
Kristal

GIA
PRODUCTION

RESTAURANT

ephesus

MAKE-UP STUDIO
Kazazi

BARNATORE

PARKING • AUTO LARJE • RE

CEKI
PARKING

H U L U M T I M

SHENJËZIMI DHE REKLAMIMI

KAOTIK

NË QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT

SHËNIM: Ky hulumtim merret me identifikimin e fenomenit të degradimit vizuel të Qendrës Historike të Prizrenit përmes mungesës së shenjzimit adekuat dhe reklamimit të pakontrolluar. Hulumtimi nuk pretendon të denigrojë apo dëmtojë bizneset e veçanta që janë paraqitur përmes reklamave dhe fotografive të tyre.



PËRMBAJTJA

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Saraçët 5, 20000/Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000/Prishtinë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

029-222-771 & 038-224-967

Autor i hulumtimit: Enes Toska

Asistentë të hulumtimit: Eni Arapi dhe Fati Çeku

Falënderojmë për kontributin: Edon Mullafetahu dhe Valon Xhabali

Hyrje 4

Qëllimi i hulumtimit dhe metodologjia 4

Shenjëzimi në kontekst ndërkombëtar e rajonal 4

Interpretimi i trashëgimise kulturore e natyrore 6

Shenjëzimi në kontekst vendi 8

Shenjëzimi në Qendrën Historike të Prizrenit 10

Të gjeturat nga terreni 11

Konkulzione e rekomandime 22

Indeksi i fotografive 23

Referencat institucionale dhe bibliografike 23

Hyrje

Qendra Historike e Prizrenit mbrohet me ligj të veçantë që nga viti 2012. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohor të qëndrueshëm të kësaj zone si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.



Sinjalistika rrugore, shenjëzimi i lokaliteteve të trashëgimisë dhe tabelat interpretuese të këtyre lokaliteteve janë pjesë përbërëse, në mos esenciale të promovimit të një lokaliteti të trashëgimisë kulturore por edhe natyrore.

Përshtypja e parë e një vizitori kur e viziton qytetin e Prizrenit është mungesa e shenjëzimit adekuat të lokaliteteve të trashëgimisë apo edhe në raste tjera laramania apo shumëllojshmëria e shenjave dhe reklamave që paraqiten. Kjo laramani shpesh le përshtypje kaotike për një qytet historik i cili do të duhej të ishte tërheqës edhe në aspekt vizuel.



Hulumtimi "Shenjëzimi dhe reklamimi kaotik në Qendrën Historike të Prizrenit" pasqyron gjendjen e shenjëzimit në këtë zonë duke hulumtuar thellësinë e kësaj problematike dhe

jep rekomandime duke u bazuar në përvoja të ndryshme ndërkombëtare e lokale.

Qëllimi i hulumtimit dhe metodologjia

Qëllimi kryesor i hulumtimit është reflektimi i zbatimit të ligjeve të aplikueshme në aspekt të shenjëzimit dhe reklamave në Qendrën Historike të Prizrenit.

Metodologjia e punës së kryer gjatë muajve prill-qershor 2018 ka konsistuar në: hulumtimin e dokumenteve zyrtare, hulumtimin e literaturës dhe fotodokumentimin në terren në mënyrë që të arrihet një analizë sa më e plotë e gjendjes ekzistuese.

Hulumtimi përmbillet me konkuzione dhe rekomandime që i adresohen disa institucioneve të nivelit qendror dhe atij lokal, Komunës së Prizrenit.

Shenjëzimi në kontekst ndërkombëtar e rajonal


Në botë ekzistojnë standardet e përcaktuara për sinjalistikë rrugore dhe shenjëzim të lokaliteteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Edhe pse ato mund të variojnë nga shteti në shtet ajo që është e përbashkët është ngjyra e kaftë/e artë e cila e simbolizon këtë standard ndërkombëtar.



Edhe lokalitetet e trashëgimisë botërore të UNESCO-s përmbajnë të njëjtin standard vetëm se shënohet qartë edhe simboli mbrojtës i UNESCO-s.



Konventa gjithashtu përcakton një emblemë mbrojtëse për të lehtësuar identifikimin e pronës kulturore të mbrojtur gjatë konfliktit të armatosur, të njohur si Mburoja e kaltër (Blue Shield). Një përdorim i trefishtë i kësaj shenjeje përcakton një pronë jashtëzakonisht të rëndësishme kulturore nën mbrojtje të veçantë. Kjo iniciativë ndikoi në krijimin e Komitetit Ndërkombëtar të Mburojës së kaltër, i cili punon për të mbrojtur trashëgiminë kulturore të botës të kërcënuar nga luftërat dhe fatkeqësitë natyrore dhe është përshkruar si ekuivalenti kulturor i Kryqit të Kuq.



Shenjëzimi në nivel ndërkombëtar përpos sinjalistikës, orientimit të vizitorëve dhe promovimit të lokaliteteve, përdorë edhe standarde të veçanta dhe mund të përqojë edhe mesazhe të ndryshme sikurse dy shembujt në vijim:

“Mburoja e kaltër”

Konventa e Hagës është traktati i parë ndërkombëtar që synonte mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në kontekst të luftës dhe theksonte konceptin e trashëgimisë së përbashkët. Ajo u miratua në vitin 1954 si përgjigje ndaj dëmtimit të gjerë dhe plaçkitjes së pronës kulturore gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Konventa kërkon që shtetet palë, gjatë paqes, të përgatiten për ruajtjen e pronës kulturore kundër efekteve të paparashikueshme të konfliktit të armatosur dhe të respektojnë pronën kulturore që ndodhet brenda territorit të tyre, si dhe në shtetet e tjera. Kjo përfshin angazhimin për të ndaluar çdo formë vjedhjeje, plaçkitje ose keqpërdorimi të pasurisë kulturore, dhe përmbajtje nga hakmarrja ndaj një prone të tillë. Nëse një shtet okupon një shtet tjetër, shtetet palë duhet të mbështesin autoritetet kombëtare kompetente në ruajtjen e pronës së saj kulturore.



“Pllaka e kaltër”

Pllaka e kaltër (Blue plaque) është një shenjë e përhershme e instaluar në një vend publik në Mbretërinë e Bashkuar dhe vende të tjera për të përkujtuar lidhjen midis atij vendi dhe personit të rëndësishëm, ngjarjes ose ndërtesës së dikurshme në vend, duke shërbyer si një shënjes historik.

Termi përdoret në Mbretërinë e Bashkuar në dy kuptime të ndryshme. Mund të përdoret në mënyrë specifike për t'iu referuar skemës "zyrtare" të administruar nga English Heritage dhe aktualisht e kufizuar në vendet brenda Metropolit të Londrës; ose mund të përdoret në mënyrë joformale për një numër skemash të ngjashme të administruara nga organizatat anembanë Mbretërisë së Bashkuar.



Ekzistojnë gjithashtu skema të pllakave përkujtimore në mbarë botën si ato në Paris, Romë, Oslo, Dablin; dhe në qytete të tjera në Australi, Kanada, Rusi dhe Shtetet e Bashkuara, si dhe në Filipine. Format e tyre ndryshojnë mirëpo njihen si shënjes të rëndësishëm historikë.

Interpretimi i trashëgimise kulturore e natyrore

Interpretimi i trashëgimisë i referohet të gjitha mënyrave në të cilat informacioni i komunikohet vizitorëve në një vend edukativ, natyror ose rekreativ, sikurse në një muze, park apo qendër shkencore. Më konkretisht është komunikimi i informacionit mbi natyrën, origjinën dhe qëllimin e burimeve historike, natyrore ose kulturore, objekteve, lokaliteteve dhe fenomeneve duke përdorur metodologji të personalizuar ose jo të personalizuar. Disa autoritete ndërkombëtare në muzeologji preferojnë termin *ndërmjetësim* për të njëjtin koncept, duke u referuar në gjuhë të ndryshme evropiane.

Interpretimi i trashëgimisë aplikohet në qendrat e dedikuara të interpretimit ose në muze, vende historike, parqe, galeri arti, qendra natyrore, kopshte zoologjike, akvariume, kopshte botanike, rezervate natyrore dhe një sërë vendesh të tjera të trashëgimisë.



Modalitetet e interpretimit mund të jenë shumë të ndryshme dhe mund të përfshijnë shëtitje me guidë, biseda, drama, performanca, shenja, etiketa, vepra arti, broshura, materiale interaktive, audio-guida dhe media audio-vizuale. Procesi i zhvillimit të një qasjeje të strukturuar për interpretimin e këtyre tregimeve, mesazheve dhe informatave quhet planifikim interpretues.

Ata që praktikojnë këtë formë të interpretimit mund të përfshijnë rojtarë/kujdestarë, guida, natyralistë, aktorë (të cilët mund të veshin rroba të periudhës specifike për interpretim më origjinal), kuratorë muzesh, specialistë interpretues natyror dhe kulturor, zyrtar të interpretimit, komunikues të trashëgimisë, edukatorë, staf shërbyes për vizitorë, përkthyes, etj. Procesi interpretues shpesh ndihmohet nga teknologjitë e reja siç janë teknikat e vizualizimit.



Parimet e interpretimit të trashëgimisë

Freedman Tilden është kredituar nga shumë njerëz si themelues i lëvizjes së interpretimit, me librin e tij "Interpretimi i trashëgimisë sonë". Tilden krijoi 6 parime për model të interpretimit dhe këto janë paraqitur si më poshtë:

1. Çdo interpretim që nuk ndërlidhet me atë që shfaqet ose përshkruhet në diçka brenda personalitetit ose përvojës së vizitorit, do të jetë sterile.

2. Informacioni, si i tillë, nuk nënkupton interpretim. Interpretimi është kumtim/zbulim i bazuar në informacion. Por ato janë gjëra krejtësisht të ndryshme. Megjithatë, të gjitha interpretimet përfshijnë informacion.

3. Interpretimi është art, i cili kombinon shumë arte, edhe nëse materialet e paraqitura janë shkencore, historike ose arkitekturore. Çdo art deri në një masë edhe mësohet.

4. Qëllimi kryesor i interpretimit nuk është mësimi/njoftimi, por provokimi.

5. Interpretimi duhet të synojë të paraqesë tërësinë në vend të një pjese dhe duhet t'i drejtohet të gjithë njerëzve e jo vetëm ndonjë faze.

6. Interpretimi drejtuar fëmijëve (të themi deri në moshën dymbëdhjetë vjeçe) nuk duhet të jetë një dobësim / tëhollim i prezantimit për të rriturit, por duhet të ndjekë një qasje krejtësisht të ndryshme. Për një interpretim të zhvilluar mirë do të duhet të ndiqej një program i veçantë.





Edhe reklamimi komercial në zona të ndryshme historike rregullohet me dizajne të veçanta të cilat nuk e dëmtojnë integritetin dhe vlerat e objekteve historike. Aty zakonisht aplikohet një liri më e madhe artistike e shprehjes por prapëprapë udhëzimet grafike ipen nga institucionet kompetente.



Vendet fqinje të Kosovës, apo edhe më gjerësisht ato të Ballkanit perëndimor e kanë të zhvilluar relativisht mirë fushën e sinjalistikës, shenjëzimit dhe interpretimit të lokaliteteve të trashëgimisë. Në kuadër të kësaj, edhe reklamimi komercial duket të jetë e kontrolluar, sidomos ato në qendrat historike.

Kjo reflektohet në shumë qytete të ndryshme, sidomos ato që kanë një stad më të lartë të turizmit.



Shenjëzimi në kontekst vendi

Kosova në përgjithësi nuk e ka të rregulluar fushën e sinjalistikës rrugore, shenjëzimin e lokaliteteve të trashëgimisë dhe nuk ka të zhvilluar modele të interpretimit të këtyre lokaliteteve. Në Ministrinë e Kulturës thonë se ka nisur projekti për shenjëzimin e trashëgimisë kulturore, dhe se ky proces është në fazë të hartimit të udhëzuesit për shenjëzim/interpretim, ndërsa ky proces është parë si i vonë në raport me vendet fqinje.

Vjollca Aliu, drejtoreshë në Departamentin e Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës, ka thënë se shenjëzimi i trashëgimisë kulturore do të bëhet në tri nivele. "Shenjëzimi nëpër rrugë magjistrale, nëpër qytete dhe shenjëzimi brendapërbrenda lokaliteteve ose asteve të trashëgimisë kulturore", derisa ka thënë se e kanë kryer fazën e parë të projektit. "Informatat e para i kemi dërguar në Ministrinë e Integritimit sepse është proces që koordinohet bashkë me Ministrinë e Integritimit, prej të cilëve janë kërkuar dhe disa plotësime në formular, që të qartësohet se çfarë po kërkojmë", është shprehur Vjollca Aliu. Ajo ka thënë se shenjëzimi i trashëgimisë kulturore orienton qytetarët më lehtë dhe në një farë mënyre mund të rrisë edhe numrin turistëve.¹

Në vijim do të listohen dhe analizohen ligjet, dokumentet dhe vendimet në fuqi dhe rekomandimet e tyre rreth shenjëzimit dhe reklamimit në nivel vendi dhe atë në mënyrë specifike në Qendrën Historike të Prizrenit:

Ligji i për trashëgiminë kulturore nr. 02/L-88, neni 6.10, përcakton që trashëgimia arkitekturale nën mbrojtje shenjëzohet qartë me një shenjë të dukshme. Vendosja e materialeve reklamuese në monumentet arkitekturale, ndërtesat e asambleve ose brenda hapësirave konservuese arkitekturale bëhet me leje të shkruar nga Institucioni kompetent.

Strategjia kombëtare për trashëgimi kulturore 2017-27 ka përcaktuar dy indikatorë, gjegjësisht veprime orientuese tek Objektivi 4.2. Zhvillimi i turizmit kulturor në bazë të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm rreth kësaj çështjeje, dhe ato janë: 1. Hartimi i udhëzuesve për shenjëzim/ interpretim dhe 2. Standardizimi i pikave të informimit sipas modelit të përzgjedhur dhe shenjëzimi i aseteve/lokaliteteve të trashëgimisë kulturore.

Në mungesë të ligjit dhe udhëzimeve adekuate disa komuna të Kosovës me përkrahje edhe të donatorëve të ndryshëm kanë adoptuar modelet e veta të shenjëzimit të trashëgimisë kulturore për nevojat e tyre.

Ato kanë aplikuar modele të ndryshme nga standarde ndërkombëtare. Në vijim po i paraqesim shembujt nga Komuna e Vushtrrisë (dy fotot në vijim), Gjakovës e Mitrovicës si dhe nga Çarshia e Gjatë dhe shpella e Radacit në Pejë (fotot në vazhdim).



¹ <http://zeri.info/kultura/82318/shenjezimi-per-mbrojtte-dhe-promovim-te-trashegimise-kulturore/> Qasur më 31 Maj 2018



Shenjëzimi në Qendrën Historike të Prizrenit

Në qytetin e Prizrenit dhe në mënyrë të veçantë, në qendrën historike të saj gjendja e shenjëzimit si dhe e reklamave komerciale paraqitet më se kaotike. Arsye për këtë është niveli jo i kënaqshëm i normativave ekzistuese, moszbatimi i tyre por edhe mungesa e udhëzuesve teknik për biznese që do të rregullonte këtë fushë.

Kjo problematikë shprehet edhe më shumë kur kemi një nivel të ulët të vetëdijes qytetare duke mos aplikuar standarde ndërkombëtare të shenjëzimit të një qyteti historik.

Plani i konservimit dhe i zhvillimit i zonës historike të Prizrenit

Plani i konservimit dhe i zhvillimit i zonës historike të Prizrenit i hartuar më 2006 dhe i adoptuar më 2009 si Plan Rregullues i Hollësishëm jep rekomandime të përgjithshme por jo dhe udhëzues grafik për rregullimin e shenjëzimit në qendrën historike të qytetit. Rekomandimet specifike janë dhënë në vijim:

Materialet e shenjave dhe skema e ngjyrave duhet të respektojnë materialin dhe skemën e ngjyrave të objektit, si dhe karakterin e pamjes rrugore. Materialet e lejuara janë druri, druri i ngjyrosur, metal i petëzuar, hekuri i farkuar, bronzi, apo legura të tjera, gur, xham apo material plastik vetëm si fleta të petëzuara. Materialet që nuk janë të lejuara janë alumini i anodizuar, azbesti dhe fletat e plastikës apo vinilit të shtypura digjitalisht, të përdorura në ndonjë mënyrë tjetër pos asaj të specifikuar.²

Shenjat për dyqane individuale duhet të vendosen në atë mënyrë që të mos mbulojnë ndonjë detaj integral arkitektonik. Shenjimi i trashëgimisë historike, sikurse gdhendjet tradicionale në llaq, relievet në dru ose gdhendjet në gurë, etj. të cilat dëshmojnë informata për emrin origjinal të objektit, vitin e ndërtimit, emrin e pronarit të vjetër ose të gjitha informatat tjera të trashëgimisë historike duhet të ruhen.³

Ligji për Qendrën Historike të Prizrenit

Qëllimi i këtij ligji të sponsorizuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të aprovuar më 2012, është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohor të qëndrueshëm të Qendrës Historike të Prizrenit si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme dhe të klasifikuar si Zonë e veçantë e mbrojtur me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar.

Sipas po këtij ligji, neni 6, një ndër aktivitetet e kufizuara në këtë zonë paraqet vendosjen e reklamave të përhershme, shenjave private, dekorimeve apo elementeve penguese me sipërfaqe më të madhe se një metër katror

² Normativat për detajet dhe dekorimet nga Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit (2009)

³ Detajet dhe ornamentet e arkitekturës qytetare nga Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit (2009)

(1m²) dhe pa pëlqimin e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit.

Për më tepër, sipas Nenit 21 të po të njëjtit ligj, Komuna e Prizrenit, në kuadër të fushëveprimit të saj, themelon një Zyrë për Qendrën Historike të Prizrenit. Kjo zyrë ka katër fushëveprimtari, prej të cilave e katërta ka mandat të nxjerrjes dhe shpërndarjes së informatave të sakta sa i përket Qendrës Historike të Prizrenit, përfshirë hartat informuese, listën e shërbimeve të ofruara, agjendat kulturore dhe reklamat. Kjo Zyre, që nga viti 2012, shkak u i neglizhencave institucionale të nivelit qendror por edhe atij lokal ende nuk është themeluar.

Vendimi mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit

Komuna e Prizrenit, në vitin 2015, pas aprovimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit adopton edhe një Vendim të veçantë mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit, përfshi edhe ato në Qendrën Historike të qytetit.

Sipas këtij Vendimi lejimi për vendosjen e Tabelave dhe Reklamave në Qendrën Historike të Prizrenit do të përcaktohet sipas kushteve dhe kriterëve duke respektuar vlerat kulturore-historike të objekteve dhe lokacioneve. Nenet më specifike të këtij vendimi janë përshkruar më poshtë:

Në nenin 2.1 të këtij Vendimi thuhet se "Vendosja e reklamave, shenjave private, dekorimeve nuk duhet të jetë në sipërfaqe më të madhe se një metër katror (1m²), dhe me pëlqim paraprak të Insitutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Prizrenit. Por varësisht prej madhësisë dhe natyrës së ndërtesës, institucioni kompetent (QRTK Prizren) mund të kërkojë që këto reklama të jenë edhe më të vogla ose të mos lejohet vendosja fare".

Neni 2.2: Reklamat nuk lejohen të vendosen në pullaz të ndërtesës, në elemente dekorative të saj si dhe në pjesë ku ajo e rrezikon strukturën e ndërtesës si dhe në pjesën ku ajo pengon vizurat në vet ndërtesën apo ndërtesat përreth saj.

Neni 2.3: Varësisht nga madhësia e fasadës, reklama nuk duhet të zë më shumë se 20% e sipërfaqes ku ajo vendoset.

Neni 2.6: Materiali i reklamës nuk mund të jetë emetues (rrezatues) i dritës (në formë ekrani) ose që brenda saj të ketë burim drite.

Neni 2.7: Reklama nuk lejohet të formohet me drita fluroshente, as me drita lëvizëse (dinamike).

Neni 2.9: Kur natyra e ndërtesës nuk mundëson vendosjen e reklamës, ose kur ndërtesa ka vlerë të lartë kulturore, historike etj, atëherë reklama vendoset në xham të vitrinës ose të aneksuar (sipas udhezimeve të QRTK-së);

Neni 2.10: Materiali i reklamës nuk guxon të dëmtojë ndërtesën ose kalimtarët në çfarëdo mënyre;

Neni 2.11: Reklama mund të shkruhet në materiale të ndryshme (në përputhje me pikën 5) dhe ajo (reklama) mund të ndriçohet me një dritë të bardhë (jo me ngjyra) jashtë saj.

Në fund, duhet të ceket poashtu se në Qendrën Historike të Prizrenit vërehet një mungesë e tabelave të interpretimit si në muzetë e qytetit por edhe në monumente të trashëgimisë, ku përjashtim bën ndoshta vetëm Kalaja e Prizrenit.



Të gjeturat nga terreni

Sa i përket sinjalistikës rrugore, shenjëzimit të lokaliteteve të trashëgimisë dhe tabelave interpretuese, ky hulumtim nuk mund të analizojë zbatimin e tyre, përderisa nuk është e rregulluar me legjislacionin përkatës. Siç është cekur edhe në pjesë tjera të hulumtimit, këto shenja janë bërë nga donatorë e projekte të ndryshme me iniciativë vetanake.

Hulumtimi për vendosjen e tabelave dhe reklamave komerciale në Qendrën Historike të Prizrenit është bërë me anë të identifikimit

të tyre me vrojtim në fasadat rrugore, përcaktimi i adresës së saktë ku është bërë edhe fotodokumentimi i tyre.

Duhet të ceket që ky hulumtim merret me identifikimin e fenomenit të degradimit vizuel të Qendrës Historike të Prizrenit përmes mungesës së shenjëzimit adekuat dhe reklamimit të pakontrolluar. Hulumtimi nuk pretendon të denigrojë apo dëmtojë bizneset e veçanta që janë paraqitur përmes reklamave dhe fotografive të tyre.

Gjatë hulumtimit në terren janë vërejtur edhe problematika të ndryshme që nuk precizohen saktë nga Vendimin mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit në fuqi, sikurse:

Prezenca e shumëllojshmërisë së reklamave dhe ato të formatit në kënd go shkallë në raport me fasadën e ndërtesave:



Reklammat që paraqiten në dy e më tepër fasada të së njëjtës ndërtesë:



Poashtu, nga normativat në fuqi, nuk është e qartë nëse në një ndërtesë kemi më shumë se një biznes, a vlenë përkufizimi 1m² për fasadë apo për secilën reklamë veç e veç ?



Nga ky hulumtim janë identifikuar gjithsej 224 ndërtesa që kanë tabela dhe reklama komerciale të bizneseve të ndryshme që janë në kundërshtim me Ligjin për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Vendimin mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit.

Në fund, të cekim se dobësi tjetër e institucioneve të nivelit qendror dhe atyre lokale është mungesa e monitorimit të shkejeve të tilla dhe mosshqiptimi i gjobave ndaj subjekteve që vendosin reklama pa leje të institucioneve relevante të trashëgimisë. Deri sot është evidentuar vetëm një e tillë e shqiptuar nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës⁴.

Në vijim gjeni të bashkangjitur hartëzimin dhe fotodokumentimin e tablave dhe reklamave komerciale. Në këto harta janë paraqitur rastet më të mëdha të shkeljeve, përderisa EC posedon databazën e plotë të të dhënave që mund të jenë në shërbim të institucioneve përkatëse.

Shembull: Në sheshin Shadërvan gjenden gjithsej 39 reklama që tejkalojnë normativat e lejuara, përderisa në panel janë paraqitur 12 rastet më të mëdha të shkeljeve dhe është paraqitur numri +27, gjë të tregon se janë gjithsej 39 raste të identifikuara të shkeljeve. Me të njëjtin parim prezantohen shkeljet tjera në sheshet dhe rrugët e Qendrës Historike të Prizrenit.

⁴ Vendimi Anr 83/2017 të datës 07 06 2017 me gjobë në vlerë 3200 Euro të ankesës së KDI ndaj koalicionit PDK-AAK-NISMA në Kino Lumbardhi



SHESHI SHADËRVAN





SHESHI I LIDHJES



SHESHI 7 KORRIKU





RRUGA ADEM JASHARI



RRUGA MARIN BARLETI






RRUGA REMZI ADEMAJ



RRUGA BAJRAKLI





RRUGA SARAÇET



RRUGA SAHATKULLA



RRUGA SHËN FLORI





RRUGA SHUAIB SPAHIU



RRUGA BESIM NDRECAJ



RRUGA FARKATARËT





RRUGA VATRA SHOIPTARE



RRUGA PUSHKATARËT



RRUGA SUZI ÇELEBIA





RRUGA ISMET JASHARI KUMANOVA



RRUGA XHEMIL FLUKU



RRUGA PAPA GJON PALI II




RRUGA NIKOLLA TESLLA



RRUGA ALEKSANDËR FLEMINGU





RRUGA FEHMI LLADROVCI



RRUGA RIFAT KRASNOI



RRUGA MBRETI ZOG



RRUGA HYSEN REXHEPI



RRUGA ILIAZ KUKA



RRUGA MIMAR SINAN



Konkluzione e rekomandime

Në bazë të të dhënave të prezantuara në këtë hulumtim, gjendja e shenjëzimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në Qendrën Historike të Prizrenit përfshirë këtu edhe vendosjen e shenjave dhe reklamave në fakt reflekton edhe gjendjen e përgjithshme të kësaj fushe në nivel vendi.

Fillimisht mungon legjislacioni në nivel qendror, përderisa në nivel lokal edhe pse ekzistojnë disa dokumente, ligje dhe vendime që rregullojnë këtë lëmi vërehet një mosvullnet i zbatimit të tyre qoftë nga institucionet apo edhe nga vet bizneset dhe qytetarët.

Komuna e Prizrenit ka dëshmuar se nuk mund ta kontrollojë gjendjen duke mos aplikuar gjoba për shkelësit e ligjit si dhe nuk jep udhëzime detaje se si duhet të dizajnohen ato. Për më tepër, Komuna nuk gjeneron edhe të ardhura nga këto reklama gjë që në vendet tjera është praktikë që aplikohet.

Në përgjithësi vërehet një tendencë tek partitë politike, organizatat por edhe tek bizneset që reklamën të vendosen pa leje dhe pëlqim të organeve kompetente të trashëgimisë kulturore. Si rrjedhojë evidentohen edhe dëmtime fizike në monumente dhe degradim i përgjithshëm vizuel në qendër historike për qëllime reklamimi.

Në vijim gjendet një listë me rekomandime të adresuara në dy nivele të ndryshme se si të trajtohen problematikat dhe sfidat e paraqitura në këtë aspekt:

Institucioneve të nivelit qendror

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Infrastrukturës të përfundojnë sa më parë përcaktimin e legjislacionit për standardizimin e sinjalistikës rrugore për lokalitetet e trashëgimisë kulturore.
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Infrastrukturës të përfundojnë sa më parë udhëzuesin për komunat e Kosovës ku do të përcaktohej formati teknik i shenjave për sinjalistikë rrugore dhe atë këmbësorike përfshi edhe çështjen e shumëgjuhësisë që duhet të paraqitet tek shenjat e trashëgimisë kulturore.

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministria e Infrastrukturës të përfundojnë sa më parë përcaktimin e legjislacionit për standardizimin e sinjalistikës rrugore për lokalitetet e trashëgimisë natyrore.

Komunës së Prizrenit

- Përditësimi dhe përmirësimi i Vendimit mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit duke i shtuar disa nene përkatëse dhe duke qartësuar disa të tjera.
- Hartimi i udhëzuesit grafik për shenja dhe reklama në Qendrën Historike të Prizrenit. Ky udhëzues duhet të trajtojë saktë se si adresohen këto reklama në ndërtesa të trashëgimisë kulturore dhe ato të reja.
- Pas përditësimit të Vendimit dhe hartimit të udhëzuesit teknik, paralajmërimi i të gjithë pronarëve në Qendrën Historike të Prizrenit për tejkallim në reklamave dhe përcaktimi i një afati (propozim: 3 mujor) për përmirësim të tyre nga vet pronarët
- Të aplikohen tarifa të veçant dhe taksa për reklamim në mënyrë që Komuna të gjenerojë të ardhura
- Në rast të mosrespektimit nga ana e pronarëve, të aplikohen gjoba sipas ligjit në fuqi dhe të largohen reklamën që janë në kundërshtim me Ligjin për qendrën historike të Prizrenit dhe Vendimit mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit
- Pas aprovimit të standardeve nga niveli qendror, dizajnimi dhe vendosja e sinjalistikës rrugore këmbësorike për lokalitetet e trashëgimisë kulturore me aprovim të institucioneve kompetente të trashëgimisë kulturore.
- Dizajnimi dhe vendosja e paneleve interpretuese në monumentet e Qendrës Historike të Prizrenit me aprovim të institucioneve kompetente të trashëgimisë kulturore.
- Hartimi i aplikacioneve për telefona të mençur të cilat do të bashkëvepronim me barkod të vendosur në muret e jashtme të monumenteve të qytetit të Prizrenit.

Indeksi i fotografive

Të gjitha fotografitë e këtij hulumtimi janë pronë e EC Ma Ndryshe përpos këtyre të poshtëcekura:

Faqe 4 (sipër): Sheshi Shadërvan në Qendrën Historike të Prizrenit, autor: Berat Hoxha

Faqe 5 (sipër): Basilica Menor de la Merced, Cuzco, Peru, autor: Nancy C. Wilkie; (poshtë): Vienë, Austri <https://www.uscbs.org/>

Faqe 6 (djathtas sipër) autor: William J. Bechmann III, (djathtas poshtë): <http://visitseeleysbay.ca> (dy foto majtas): English Heritage plaque at 153 Cromwell Road, London; Greater London Council plaque at 29 Fitzroy Square, London autor: Simon Harriyott

Faqe 7 (majtas sipër) autor: Nick Butcher (majtas poshtë): siny.com.cn; (djathtas sipër): <https://bwa.design> (djathtas poshtë): DoPgW7 Alamy Stock Photo

Faqe 8 (majtas sipër) autor: Steve Pardue, (majtas në mes): Facebook New Zealand ww100, (majtas poshtë) autor: John Trax / Alamy Stock Photo, (djathtas në mes) Shodra <http://www.albanien-info.com/shkodra/>, (djathtas poshtë) Pazari i Vjetër i Korçës <http://po.al/>

Faqe 9 (2 fotot djathtas sipër) si dhe faqe 10 (majtas sipër) Cultural Heritage without Borders Kosovo <http://chwb.org/kosovo/>

Faqe 10 (majtas në mes): Promotion of Heritage Management PHM West <http://www.phm-west.org/>

Faqe 11: <https://xk.usembassy.gov>

Referencat institucionale dhe bibliografike

The Blue Shield International, <http://www.ancbs.org>

The English Heritage, <http://www.english-heritage.org.uk/visit/blue-plaques/>

Harta: Prizreni me emërtime të reja të rrugëve, Komuna e Prizrenit, <https://kk.rks-gov.net/prizren/>

Strategjia Kombëtare për trashëgimi kulturore 2017-27, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, <http://www.mkrs-ks.org/>

Ligji nr. 04/L-066 Për Qendrën Historike Të Prizrenit, <https://gzk.rks-gov.net/>

Vendimin mbi vendosjen e tabelave dhe reklamave në territorin e qytetit të Prizrenit i 26 02 2015, Komuna e Prizrenit – DUPH

Brochu, Lisa (2003). Interpretive planning. Fort Collins, CO: InterpPress. ISBN 1-879931-12-5.

Brochu, Lisa; Merriman, Tim (2002). Personal Interpretation: Connecting Your Audience to Heritage Resources. Fort Collins, CO: InterpPress. ISBN 1-879931-06-0.

Caputo, Paul; Lewis, Shea; Brochu, Lisa (2008). Interpretation by Design: Graphic Design Basics for Heritage Interpreters. Fort Collins, CO: InterpPress. ISBN 1-879931-25-7.

Ham, Sam (1992). Environmental Interpretation: A Practical Guide for People with Big Ideas and Small Budgets. Golden, CO: Fulcrum Publishing. ISBN 1-55591-902-2.

Levy, Barbara; Lloyd, Sandra; Schreiber, Susan (2001). Great Tours! Thematic Tours and Guide Training for Historic Sites. Walnut Creek, CA: AltaMira Press. ISBN 0-7591-0099-3.

Moscardo, Gianna; Ballantyne, Roy; Hughes, Karen (2007). Designing Interpretive Signs: Principles in Practice. Golden, CO: Fulcrum Publishing. ISBN 978-1-55591-550-6.

Pastorelli, John (2003). Enriching the Experience: An Interpretive Approach to Guiding. French's Forest, Australia: Hospitality Press. ISBN 1-86250-522-5.

Regnier, Kathleen; Gross, Michael; Zimmerman, Ron (1994). The Interpreter's Guidebook: Techniques for Programs and Presentations (3rd ed.). Stevens Point, WI: UW-SP Foundation Press. ISBN 0-932310-17-6.

Ward, Carolyn; Wilkinson, Alan (2006). Conducting Meaningful Interpretation: A Field Guide for Success. Golden, CO: Fulcrum Publishing. ISBN 978-1-55591-530-8.

Sideris A., 2008. "Re-contextualized Antiquity: Interpretative VR Visualisation of Ancient Art and Architecture" Archived 2018-04-24 at the Wayback Machine. in Mikropoulos T. A. and Papachristos N. M. (eds.), Proceedings: International Symposium on "Information and Communication Technologies in Cultural Heritage" October 16–18, 2008, University of Ioannina 2008, ISBN 978-960-98691-0-2, pp. 159-176.

